



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:037759
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05506434

PPP.nr.56/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmesgjyqtarit Blerand Rrmoku, ne çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditorit L.I nga fshati S, Komuna G, i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga R.P, avokat me seli në P, kundër debitorës K.S "D", me seli në P, Rr. "D" nr..., lagja L, lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit në bazë të titullit ekzekutiv – aktgjykimit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga ana e palës debitore, kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.06/24, të dt.15.01.2024,të lëshuar nga Përmbartuesi Privat D.G në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 26.03.2024, mori dhe në të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i ushtruar nga pala debitore K.S "D", me seli në P, ndërsa Urdhëri Përmbartimor P.nr.06.24, i dt.15.01.2024, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat D.G në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat D.G në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit L.I, ka lëshuar Urdhërin Përmbartimor nën shenjën P.nr.06/24, të datës 15.01.2024, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të titullit ekzekutiv - aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7233/2022, të dt.02.11.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, C.nr.449/18, të dt.09.08.2022, përmes të cilit urdhër është obliguar pala debitore që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit t'ia paguajë kreditorit shumën prej 5,276.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër Urdhrit Përmbartimor të lartëcekur, brenda afatit të përcaktuar ligjor, prapësim ka paraqitur pala debitore. Në prapësimin e ushtruar fillimisht pretendohet se me rastin e marrjes së aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, C.nr.449/18, të dt.09.08.2022

si dhe aktgjykimet të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7233/2022, të dt.02.11.2023, gabimisht janë zbatuar dispozitat ligjore nga e drejta materiale. Tutje theksohet se debitori nuk mund të kryejë pagesa të cilat krijojnë pasurim të pa bazë për kreditorin, ndërsa lidhur me këto pretendime kanë ushtruar revizion pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, duke kërkuar që të pritët deri në marrjen e vendimit sipas revizionit, mbi bazën e pretendimeve që kemi të bëjmë me vendime të përfshira me shkelje të shumta. Mbi këtë bazë, ka propozuar që urdhëri për përmbarim të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka paraqitur përgjigje në prapësim, ku ndër tjera theksohet se pala debitore pa asnjë argument ligjor apo provë e kundërshton përmbushjen e detyrimit në bazë të dokumentit përmbarimor - aktgjykimet të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7233/2022, të datës 02.11.2023, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm sipas nenit 22 par.1, nënpar 1.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Tutje në përgjigje në prapësim, pala kreditore i është referuar edhe dispozitave nga nenet 24 par.1 dhe 27 të LPP-së, si dhe neneve 166 dhe 213 të LPK-së. Lidhur me pretendimet se me rastin e marrjes së aktgjykimeve mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi, nuk janë zbatuar drejtë dispozitat ligjore nga e drejta materiale, të njejtat i ka kundërshtuar mbi bazën e pretendimit se vendimi është marrë në përpikmëri me këto dispozita, mirëpo pala debitore ka paraqitur prapësim vetëm me qëllim të prolongimit të procedurës përmbarimore. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa Urdhëri Përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas vlerësimit me kujdes dhe vëmendje të pretendimeve të përfaqësuesit të palës debitore, të parashtruara në prapësim, pretendimeve të përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të provave të cilat gjenden në dispozicion në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se prapësimi është i pa bazuar, mbi bazën e arsyeve si në vijim:

Dispozita nga 21 e Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tani e tutje LPP), e cila i referohet bazës juridike për caktimin e përmbarimit, parasheh që: "*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*". Në anën tjetër, dispozita nga neni 22 par.1 e LPP-së, përcakton llojet e dokumenteve në bazë të të cilave mund të caktohet përmbarimi. Në nënpar 1.1 të këtij neni përcaktohet: "*Dokumente përmbaruese janë: 1.1.vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese*". Në këtë funksion, dispozita nga neni 23 par.1 përcakton se: "*Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit*". Në anën tjetër, dispozita nga neni 24 par.1, e cila i referohet përmbarueshmërisë së vendimit gjyqësor, parasheh që "*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare*". Elementet të cilat duhet t'i përmbajë një dokument përmbarimor janë të përcaktuara saktësisht në dispozitën e nenit 27 par.1 të LPP-së, ku parashihet: "*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*". Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që

elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, ndërsa mungesa e njërit prej tyre, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbarrim.

Në rastin konkret, përmbarrimi është lejuar në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, i evidentuar nën shenjën C.nr.449/18, i dt.09.08.2022. Aktgjykimi në fjalë është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7233/2022, të dt.02.11.2023, me ç'rast është bërë i plotfuqishëm në të njëjtën datë. Në këtë mënyrë, aktgjykimi i lartëcekur është i pajisur edhe me klauzolën e plotfuqishmërisë, në kuptim të dispozitës nga neni 36 par.1 dhe 2 të LPP-së.

Gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, me theks të veçantë aktgjykimit me të dhënat e sipërcekura, erdhi në përfundim se i njëjti i përmban të gjitha tiparet e dokumentit përmbarrues. Kjo për faktin se aktgjykimi në fjalë paraqet vendim gjyqësor i cili është bërë i formës së prerë, me rastin e parashtrimit të propozimit për përmbarrim ka skaduar afati për përmbushje vullnetare, ndërsa në dispozitiv është treguar kreditori dhe debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Nga zbërthimi i aspekteve të tilla, rrjedh se aktgjykimi i lartëcekur i përmbushë të gjitha kriteret e kërkuara ligjore për të shërbyer si bazë për caktimin e përmbarrimit, në kuptim të dispozitave nga nenet 22 par.1 pika 1.1, 23 par.1, 24 par.1 dhe 27 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore.

Pretendimet e palës debitore, të parashtruara përmes prapësimit, përqendrohen në faktin se aktgjykimet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi janë të përfshira me zbatim të gabuar të dispozitave nga e drejta materiale dhe lidhur me këtë pala debitore pa paraqitur edhe revizion pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në përgjigje lidhur me këto pretendime, Gjykata fillimisht sjellë në vëmendje faktin se procedura përmbarrimore udhëhiqet nga parimi i rigorozitetit formal, mbi bazën e të cilit parim pamundësohet shqyrtimi i ligjshmërisë dhe mënyrës së vendosjes përmes vendimit gjyqësor, i cili ka shërbyer si dokument mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi. Objekt shqyrtimi në këtë procedurë është vetëm vlerësimi i faktit nëse dokumenti i prezantuar paraqet dokument përmbarrimor, respektivisht nëse i përmban elementet e përcaktuara me dispozitat e lartëcituara të LPP-së, për të qenë i përshtatshëm për të iu nënshtruar përmbarrimit. Lidhur me pretendimin e palës debitore se kundër aktgjykimeve të lartëcekura është paraqitur revizion pranë Gjykatës Supreme, Gjykata vlerëson se revizioni si mjet i jashtëzakonshëm i goditjes në procedurë kontestimore, nuk mund të ketë efekt suspenziv lidhur me përmbarrimin e një vendimi gjyqësor i cili ka marrë formën e prerë, në kuptim të dispozitës nga neni 213 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku shprehimisht përcaktohet që: "*Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarrimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur.*"

Mbi këtë bazë, pretendimet e palës debitore nuk gjejnë mbështetje në prova konkrete dhe në dispozitat në fuqi të LPP-së, dhe si të tilla janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje. Nga arsyet e lartëcekura, në mbështetje të dispozitës së nenit 73 të LPP-së, u vendos devidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil-
PPP.nr.56/24, datë 26.03.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të dispozitës nga neni 77 të LPP-së është lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate